



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Prill, 2026

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse gjatë muajit prill 2026
2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, forma e agreguar dhe individuale
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforsimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT PRILL 2026

Gjatë muajit prill 2026 janë raportuar 11,430 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(713.25 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (16,741 raste apo Inc. 939.39 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Influenca sezonale (ILI) me 5,456 raste ose Inc. 340.46/100,000, Diare ac. me 3,961 raste ose Inc. 247.17/100,000 banorë dhe ARI/ITPR me 1,106 raste ose 69.02 në 100,000 banorë (Tab.1).

Gjatë muajit prill 2026 janë raportuar 6 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 4 raste me dg. Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast dg. Bronchopneumonia me me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me HIV/AIDS me diagnozë përcjellëse.

Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuar në Kosovë, prill 2026 krahasuar me prill 2025

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuara në Kosovë, 01-30 prill të vitit 2026 dhe 2025				
Sëmundjet/Shkaktarët	prill, 2026		prill, 2025	
	Nr. i rasteve	Incidenca/100.00 o	Nr. i rasteve	Incidenca/100.00 o
ITPR - Pneumonia/ARI	1,106	69.02	3,301	185.23
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	24	1.50	8	0.45
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	5,456	340.46	8,739	490.37
COVID-19		0.00	3	0.17
Influenca A		0.00	3	0.17
Influenca B	3	0.19	2	0.11
RSV	9	0.56	12	0.67
Diarea akute	3,961	247.17	4,000	224.45
Variçela	534	33.32	398	22.33
Sindromi meningjeal	24	1.50	11	0.62
Kampilobakter	1	0.06		0
Helmimet me ushqim	64	3.99	71	3.98
Salmonella enteritidis	16	1.00		0
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale dhe me Rotavirus	19	1.19	3	0.17
Gastroenterokolitet	74	4.62	118	6.62
Hepatiti akut B	1	0.06	3	0.17
Hepatiti akut C	1	0.06	1	0.06
Rubeolla		0.00	1	0.06
Morbilli	8	0.50		0
Parotiti epidemik	3	0.19	1	0.06
Pertussis	1	0.06	1	0.06
TBC	45	2.81	33	1.85
Brucelosis	3	0.19	2	0.11
Echinococcus		0.00	1	0.06
Sëmundja Lyme		0.00	1	0.06
Toxoplasmosis		0.00	1	0.06
Leishmania	1	0.06		
HIV	2	0.12	1	0.06
IST	23	1.44	19	1.07
Clostridium difficile		0.00		0
Giardiaza	8	0.50	4	0.22
Infeksionet strptokoksike të grupit A	30	1.87		
*Sëmundjet tjera ngjitëse	13	0.81	3	0.17
Gjithsej	11,430	713.25	16,741	939.39

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Scarletina, Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucleoza

1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, PRILL 2026

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit prill 2026 në IKShPK janë raportuar 5,456 raste me ILI (Inc. 340.46/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet një ulje prej 37.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (8,769 raste të raportuara). Gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, mars 2026 me (4,785 raste të raportuara me ILI) vërehet një rritje prej 14% e numrit të rasteve. Numri i rasteve të raportuara i atribuohet sezonës dhe qarkullimit të patogjenëve respirator.

Diarea akute: Gjatë muajit prill 2026 në IKShPK janë raportuar 3,961 raste me diare akute (Inc.247.17/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,000 raste), vërehet një ulje e lehtë prej 1% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak mars 2026, me 3,460 raste të raportuara, vërehet një rritje prej 14.6% e numrit të rasteve. Numri i rasteve të raportuara me diare akute mbetet shqetësues për shëndetin publik, marrë prasysh ekspozimin e vazhdueshëm të popullatës ndaj patogjenëve të ndryshëm ushqimorë dhe atyre përmes ujit, veçanërisht kushtet e ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

ARI/ITPR: Gjatë muajit prill 2026 në IKShPK janë raportuar 1,106 raste me ARI (Inc.69.02/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (3,301 raste) vërehet një ulje prej 66.5% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak mars 2026 me (1,300 raste) vërehet ulje e numrit të rasteve për 14.9%. Numri i rasteve të raportuara lidhet kryesisht me sezonin e infeksioneve respiratore.

Variçella: Gjatë muajit prill 2026 në IKShPK janë raportuar 534 raste me Variçellë (Inc.33.32/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (398 raste) vërehet rritje prej 34.8% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak mars 2026 me 507 raste të raportuara, rritje prej 5.3% e numrit të rasteve të raportuara.

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit prill, 2026 janë raportuar 12 raste të dyshimta/mundshme me fruth prej të cilave 8 raste të konfirmuara me laborator. Të gjitha rastet e raportuara janë të pavaksinuara me vaksinën MMR. Komuna e Ferizajit paraqet përqendrimin më të lartë të rasteve (gjysma e rasteve totale), dhe 3 prej rasteve të para kanë lidhshmëri epidemiologjike me institucionet parashkollore. Shpërndarja sipas komunave: Ferizaj (4 raste), Kaçanik (2 raste), Prishtinë (1 rast) dhe Fushë Kosovë (1 rast). Sipas grup-moshës: të gjitha rastet i përkasin grup-moshës 1-2 vjeç.

Gjatë muajit prill 2026, gjithashtu janë raportuar 3 raste të konfirmuara me Parotitis. Analizuar sipas komunave: Prishtinë, Pejë dhe Fushë Kosovë me nga 1 rast. Sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 1 rast gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës: 1 rast i takon grup-moshës (1-4 vjeç) dhe 2 raste (5-9 vjeç). Gjithashtu gjatë kësaj periudhe me Pertussis gjatë muajit prill është konfirmuar 1 rast nga komuna e Skenderajit, i gjinisë femërore, grup-moshës 1-2 vjet dhe i pavaksinuar.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë muajit prill, nga laboratorit i Mikrobiologjisë/Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), janë raportuar 3 raste me Brucelozë, Sipas komunave: Istog, Prizren dhe Mamushë dhe sipas grup-moshës, me nga një rast: (20-29 vjeç), (40-49 vjeç) dhe (70-79 vjeç). Dy prej rasteve janë të gjinisë femërore dhe një rast i gjinisë mashkullore. Sipas hulumtimit epidemiologjik, rastet mohojnë kontaktin direkt me kafshë shtëpiake.

Sindroma meningjeale

Gjatë muajit prill, 2026 janë raportuar gjithsej 24 raste me Sindromën Meningjeale (*Mb. 1.50/100,000 banorë*), prej tyre 18 raste me Meningitis acuta, 2 raste me Meningitis acuta serosa, 2 raste me Meningoencephalitis acuta dhe me nga 1 rast Meningitis purulenta meningococcicae dhe Meningitis purulenta. Numri i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak (prill, 2025), ku ishin raportuar 11 raste (*Inc. 0.62/100,000 banorë*). Numri më i madh i rasteve të raportuara sipas komunave është regjistruar në Prishtinë me 5 raste, pastaj në Vushtrri me 4 raste, Fushë-Kosovë dhe Prizren me 3 raste, duke vazhduar me nga 1 rast në komunat: Glogoc (Drenas), Istog, Kamenicë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë, Pejë, Shtime dhe Viti. Sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshës, gjatë kësaj periudhe numri më i madh i rasteve është raportuar në grup-moshën 0-9 vjeç me 8 raste (33%), grup-mosha 10-19 vjeç me 4 raste (17%), grup-moshat 20-29 vjeç dhe 30-39 vjeç me nga 3 raste (13%), grup-moshat 40-49 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 2 raste (8%) dhe grup-moshat 50-59 vjeç dhe 80+ me nga 1 rast (4%). Ndërsa, nuk ka raportime nga grup-mosha 70-79 vjeç. Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, 58% (14 raste) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 42% (10 raste) i takojnë gjinisë mashkullore.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKSHPK përmes sistemit MedLIS, si dhe në laboratorin mikrobiologjik të Klinikës Infektive, janë identifikuar disa shkaktarë viralë dhe bakterial në lëngun cerebrospinal (LCS). Gjithsej janë raportuar 6 raste me izolime pozitive. Shkaktarët viralë të identifikuar janë: 4 raste me Human Herpes Virus 7 dhe 1 rast me Human Enterovirus. Ndërsa nga shkaktarët bakterial është identifikuar 1 rast me Neisseria Meningitidis. Nga rastet e raportuara gjatë muajit prill 2026, është raportuar 1 vdekje nga Meningoencephalitis cryptococci, i gjinisë mashkullore, mosha 38 vjeçare nga komuna e Gjakovës.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit prill 2026, përmes SMSN nga të gjitha regjionet janë raportuar raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (AO9); 22 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (AO4.8) ; 76 raste me dg. Intoksikacionet tjera bakteriale alimentare – (AO5); 21 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (AO4.9); dhe 8 raste me dg. Giardiasis (Giardia lamblia) (AO7.1).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive janë raportuar: 14 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 6 raste Prishtinë, 3 raste Mitrovicë, 2 raste Gjakovë, dhe me nga një rast komunat: Vushtrri Prizren dhe Rahovec. Sipas grup-moshave: 13 raste janë të grupmoshës 0-9 vjeç dhe 1 rast i grupmoshës 30-39 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 7 raste janë të gjinisë femërore dhe 7 raste të gjinisë mashkullore; 8 raste me Giardia lamblia, prej të cilave sipas komunave: me nga 2 raste janë komunat Prizren dhe Prishtinë, me nga 1 rast janë komunat Glogoc, Gjakovë, Suharekë, Deçan. Sipas grup-moshave: 3 raste te grupmoshës 0-9 vjeç, 1 rast i grupmoshës 10-19 vjeç, 2 raste të grup-moshës 20-29, 1 rast i grup-moshës 50-59, dhe 1 rast i grup-moshës mbi 65 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 5 raste të gjinisë femërore dhe 3 raste të gjinisë mashkullore; 5 raste me Adenovirus, prej të cilave; 3 raste nga komuna e Gjakovës, dhe me nga 1 rast komunat Fushë Kosovë dhe Vushtrri. Rastet i takojnë grup-moshave: 4 raste të grupmoshës 0-9 vjeç, dhe 1 rast i grup-moshës 30-39. Sipas gjinisë 4 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe një rast i gjinisë femërore; 16 raste me Salmonella enteridis prej të cilave 12 raste nga komuna e Prishtinës, 2 raste nga komuna e Vushtrrisë, dhe me nga 1 rast komunat Drenas dhe Obiliq (shih pjesa e epidemive) . Sipas grup-moshës: 0-9 vjeç me 4 raste, 10-19 vjeç me 5 raste, 20-29 me 3 raste, 30-39 me 2 raste, 50-59 me 1 rast, dhe mbi 65 vjeç me 1 rast. Sipas gjinisë: 10 rastet janë të gjinisë mashkullore dhe 6 raste të gjinisë femërore; 1 rast me Campylobacter nga komuna e Ferizajit i grup-moshës 20-29 vjeç dhe i gjinisë mashkullore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit prill 2026, janë testuar gjithsej 297 mostra të dyshimta për Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 3 raste me Influcencën B, që përfaqëson një pozitivitet prej 1.01%. Të gjitha rastet e konfirmuara me Influcencë B janë nga komuna e Mitrovicës, i përkasin grupmoshës 0–4 vjeç (1 rast), 5–14 vjeç (1 rast) dhe 15–34 vjeç (1 rast). Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, dy raste janë meshkuj dhe një rast është femër. Nga patogjenët tjerë respirator janë raportuar 9 (3.03%) mostra pozitive me RSV, 61 (20.54%) mostra pozitive me Human Rhinovirus, 14 (4.71%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 20 (6.73%) mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 24 (8.08%) mostra pozitive në Human Parainfluenza virus. Rastet pozitive me virusin sincicial respirator (RSV) sipas komunave janë: Drenas (2 raste), ndërsa me nga një rast nga komunat Ferizaj, Prishtinë, Prizren, Pejë, Obiliq, Mitrovicë dhe Vushtrri.

Gjatë muajit prill 2026, përmes raportimit në kohë reale nga Kl. Infektive, Kl. E Pediatrisë, Kl. E Pulmologjisë dhe përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjithëse (SMSN), u raportuan gjithsej 24 raste me SARI. Prej tyre 14 apo 58.3%, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan, 3 mostra pozitive në Virusin Sincicial (RSV), 3 mostra pozitive në Human Rhinovirus dhe 2 mostra pozitive në Human Metapneumovirus.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (10 raste), Ferizaj (3 raste), Drenas (3 raste), Podujevë (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Fushë Kosovë, Lipjan, Istog, Mitrovicë, Obiliq dhe Vushtrri. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është: mbi 65 vjeç (9 raste), 5-14 vjeç (4 raste), 35-50 vjeç (4 raste), 51-64 vjeç (3 raste), 0-4 vjeç (2 raste) dhe 15-34 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë, 13 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 11 gjinisë femërore. Nga të gjitha rastet SARI, 4 apo 16.7% prej tyre ishin të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Gjatë muajit prill 2026, janë raportuar 4 raste të vdekjes nga SARI (CFR= 16.7%). Rastet e vdekjes nga SARI i takojnë grup-moshës 65+ (3 raste) dhe 51-64 vjeç (1 rast), me sëmundje.

Ecuria me Tuberkuloz

Në SMSN, gjatë muajit prill 2026, janë raportuar 45 raste me Tuberkuloz apo 3.18 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Mitrovicë dhe Suharekë me nga (6 raste), Prishtinë dhe Prizren me nga (5 raste), Vushtrri dhe Malishevë me nga (4 raste), Podujevë dhe Deçan me nga (2 raste), kurse me nga 1 rast komunat: Ferizaj, Gjakovë, Fushë Kosovë, Gjiilan, Kamenicë, Lipjan, Pejë, Viti, Dragash, Rahovec dhe Graçanicë. Prej 51 rasteve të raportuara, 35 (77.7%) janë raste pulmonare dhe forma ekstra-pulmonare 10 (22.2%). Sa i përket grup-moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojnë se grup-moshat më të prekura janë 60–69 vjeç (11 raste), 75–79 vjeç (9 raste), 55–59 vjeç (7 raste), 30–39 vjeç (5 raste), grup-moshat 20–29 vjeç dhe 85–89 vjeç me nga (4 raste), 10–19 vjeç me (3 raste) dhe grup-moshat 40–49 vjeç me (2 raste). Sipas gjinisë, rezultojnë se gjinia mashkullore me 55.5% (25 raste), ndërsa 44.6% (20 raste) i takojnë gjinisë femërore.

Rastet me HIV/AIDS/IST

Gjatë muajit prill 2026, janë raportuar 2 raste me HIV/AIDS, rastet janë të gjinisë mashkullore nga komuna Suharekë dhe Gjakovë. Një rast i takon grup moshës 25-34 vjeç dhe një rast 35-44 vjeç. Kë muaj është raportuar edhe një rast i vdekjes si pasojë e AIDS nga Gjakova, i cili edhe është raportuar si rast i ri (Gjakovë) dhe i përket grup moshës 35-44 vjeç. Të dy rastet janë raportuar përmes MedLis nga mikrobiologjia dhe përmes SMSN nga Klinika Infektive.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST)

Gjatë muajit prill 2026 janë raportuar gjithsej 23 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Gjakovë 6, Prishtinë 4, Pejë 3 dhe me nga një (1) rast komunat Mitrovicë, Vushtrri, Podujevë, Istog, Klinë, Deçan, Ferizaj, Rahovec, Lipjan dhe Suharekë. Sipas diagnozës: Condyloma 12, Chlamydia 6 raste, HPV 4 raste, Gonorrhea 3 raste, dhe Sifiliz 1 rast. Sipas gjinisë: 14 raste (61%) i takojnë gjinisë femërore dhe 9 raste (39%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 15-24 vjeç 3 raste (12%), 25-49 vjeç 15 raste (70%) dhe 50+ 5 raste (18%).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C

Gjatë muajit prill, 2026 është raportuar 1 rast (Inc. 0.06/100 000 banorë) me Dg. Hepatit akut B in obs, e gjinisë femërore, 66 vjeçare nga komuna e Prishtinës krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ku janë raportuar 3 raste me Hepatit akut B (Mb. 0,17/100 000 banorë). Sa i përket Hepatitit akut C, gjatë muajit prill, 2026 është raportuar 1 rast (Mb. 0.06/100 000), e gjinisë femërore, e moshës 69 vjeçare nga komuna e Vushtrrisë. Në të njëjtën periudhë të vitit 2025 gjithashtu është raportuar 1 rast me dg. Hepatit akut C. Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast vdekje me Hepatit akut B ose C.

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, PRILL 2026

Rastet e spitalizuara në numër më të madh nga sëmundjet ngjitëse janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respirator, të pasuara me diarë akute dhe gastroenterokolite. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa pjesa tjetër raportohet bazuar në diagnozën klinike (shih Tabela 3).

Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatrië dhe spitalet e përgjithshme, prill 2026

Sëmundja/Diagnoza klinike	Rastet
Pneumonia /ARI	143
SARI	24
Sindroma meningjeale	24
Helmimet me ushqim	21
Diarea akute dhe gastroenterocolite	146
Status febrilis	14
Exanthema	2
Mononucleosis	5
Erysipela	5
Gjithsej	384

4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT PRILL 2026

Epidemia alimentare me Salmonella enteritidis në rajonin e Prishtinës

Më datë 02.04.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Prishtinë ka raportuar epidemi alimentare me diagnozë *Intoxicatio alimentaris* (A05) në rajonin e Prishtinës. Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë daton më 01.04.2026, ndërsa përfundimi i saj është raportuar më 15.04.2026. Epidemia ka përfshirë popullatën e të gjitha grupmoshave në rajonin e Prishtinës. Informata për paraqitjen e rasteve është pranuar përmes bashkëpunimit me Inspektoriatin Sanitar dhe strukturat relevante institucionale, pas dyshimeve për helmim alimentar në një lokal ushqimor në rajonin e Prishtinës.

Bazuar në hulumtimin epidemiologjik kanë qenë 799 persona të ekspozuar, prej të cilëve 35 kanë zhvilluar simptomatologji klinike, ndërsa 17 raste kanë kërkuar trajtim spitalor dhe nuk janë raportuar raste fatale.

Burimi i infeksionit është vlerësuar i njohur, ndërsa rruga e transmetimit është identifikuar si alimentare, përmes konsumimit të ushqimit të kontaminuar.

Rezultatet laboratorike : Në Laboratorin e Mikrobiologjisë, shkaktari etiologjik është konfirmuar Salmonella enteritidis nga mostrat e fecesit të rasteve të hospitalizuara, ndërsa në mostrat ushqimore dhe në strishot e marra nga ambienti i punës dhe stafi nuk është izoluar asnjë shkaktar etiologjik. Për qëllime diagnostike dhe epidemiologjike janë marrë gjithsej 7 mostra ushqimore dhe 7 strisho nga ambienti dhe stafi i lokalit të dyshuar.

Rastet e raportuara kanë manifestuar simptomatologji karakteristike për helmim alimentar si ethe, temperaturë dhe diarre. Sipas shpërndarjes sipas gjinisë, 30 raste i përkasin gjinisë mashkullore dhe 5 raste gjinisë femërore. Ndërsa sa i përket grup-moshës paraqiten grup-mosha 10-14 vjeç me 1 rast, grup-moshat 15-19 dhe 40-49 vjeç me nga 2 raste pastaj grup-mosha 20-29 vjeç me 7 raste, grup-mosha 30-39 vjeç me 4 raste, dhe 19 raste me moshë të panjohur.

Epidemia me fruth në rajonin e Ferizajt

Më datë 16 prill 2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik (QRSHP) në Ferizaj ka raportuar 3 raste të konfirmuara me Fruth në institucionin parashkollor “Hëna” në Ferizaj.

Sipas të dhënave të siguruara nga hulumtimi epidemiologjik, fillimi i epidemisë daton nga 06 prill 2026. Në institucioni parashkollor “Hëna” kanë qenë të ekspozuar 46 fëmijë, ndërsa janë regjistruar 3 raste të konfirmuara, të cilët janë hospitalizuar. Rastet e raportuara më date, 06.04.2026 kanë manifestuar simptoma si ethe, temperaturë të lartë trupore deri në 40.6°C, kollë, konjuktivit dhe rinit. Bazuar në të dhënat epidemiologjike, burimi i infeksionit mbetet i paidentifikuar, ndërsa rruga e përhapjes është vlerësuar përmes transmetimit aerogjen, respektivisht përmes spërklave respiratore gjatë kollitjes dhe teshtimës. Në kuadër të hulumtimit epidemiologjik, rastet (3) dhe kontaktet janë anketuar nga ekipet epidemiologjike të QRSHP-Ferizaj, ndërsa janë ndërmarrë masat për gjurmimin aktiv të kontakteve dhe monitorimin epidemiologjik të tyre.

Rezultatet laboratorike: shkaktari etiologjik është konfirmuar virusi i fruthit (Morbilli).

Në bashkëpunim me institucionin parashkollor janë rekomanduar masat higjieno-sanitare për kontrollin e përhapjes së infeksionit, përfshirë ajrosjen dhe dezinfektimin e rregullt të hapësirave. Gjithashtu, është rekomanduar që në institucion të mos pranohen fëmijë me status të pakompletuar të vaksinimit (sipas Qarkores informative Nr. 02/2025- Informimi i prindërve për vaksinimin e obliguar të fëmijëve: [Qarkore-informative-Nr-05-2025- Informimi-i-prindërve-rreth-vaksinimit-te-obliguar-te-femijeve.pdf](#)), ndërsa fëmijët e pavaksinuar që kanë qenë kontakte të 3 rasteve të konfirmuara të mos vijojnë institucionin parashkollor për 21 ditë pas ekspozimit.

Epidemia alimentare me Salmonella enteritidis në rajonin e Gjilanit

Më datë 28.04.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik (QRSHP) në Gjilan ka raportuar epidemi alimentare me diagnozë Intoxicatio alimentaris (Salmonellosis). Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë është raportuar më 25.04.2026, ndërsa përfundimi i saj më 04.05.2026.

Në këtë epidemi kanë qenë të ekspozuar katër (4) anëtarë të një familje, ku të gjithë kanë manifestuar simptoma si temperaturë, ethe, kokëdhimbje, nauze, vjellje dhe barkqitje të shpeshta dhe kanë kërkuar trajtim hospitalor në repartin Infektiv të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan.

Rruga e transmetimit është vlerësuar alimentare. Bazuar në hulumtimin epidemiologjik, burimi i infeksionit është identifikuar si ushqim i përgatitur në kushte shtëpiake, respektivisht salcë me kërpudha, ndërsa është ngritur dyshimi se kërpudhat nuk kanë qenë të ruajtura në mënyrë adekuate.

Sipas shpërndarjes sipas gjinisë, dy (2) raste i përkasin gjinisë mashkullore dhe dy (2) raste gjinisë femërore. Sa i përket grupmoshave, rastet i përkasin grupmoshave 10–14 vjeç, 15–19 vjeç, 40–49 vjeç dhe 50–59 vjeç.

Rezultatet laboratorike: Në Laboratorin e Mikrobiologjisë, shkaktari etiologjik është konfirmuar Salmonella enteritidis.

Në kuadër të masave epidemiologjike janë ndërmarrë hospitalizimi dhe trajtimi i rasteve, hulumtimi epidemiologjik dhe anketimi epidemiologjik i rasteve, si dhe këshillimi lidhur me ruajtjen adekuate të ushqimit dhe respektimin e higjienës personale dhe higjienës ushqimore. Gjithashtu është rekomanduar përsëritja e analizave të koprokulturës dhe përcjellja epidemiologjike e rasteve.

5. RAPORTIMI I SËMUNDJEVE NGJITËSE NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PËRMES SMSN KRAHASUAR ME ATE ME KOPJE FIZIKE, PRILL 2026

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 27 komuna ose 71.05% (27/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Dragash, Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok. Përveq komunës së Dragashit, të gjitha komunitat e cekura më lartë, gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, prill 2026

Gjatë muajit prill 2026, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) janë raportuar gjithsej 3,324 raste me sëmundje ngjitëse dhe krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve të raportuara (11,430) i shprehur në përqindje (29.1%). Gjatë muajit prill 2026 vërehet një ulje prej 6.36% e numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN, krahasuar me muajin paraprak, mars 2026. (Tabela 4).

KOMUNA	Prill 2026 KOPJE FIZIKE										SMSN												
	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Njësia Shëndetësore e Burgjeve	Institucionet Private	OKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	
DEÇAN							124	6		130									26				26
DRAGASH							52	25		77													0
DRENAS							12			12									31	48			79
F.KOSOVË										0									171	50	71		292
FERIZAJ	13					293	63	92		461							9		31	19	9		68
GJAKOVË										0	43						40		132	63			278
GJILAN						83	98	168	8	357	23							14	53			90	
GRAÇANICË										0													0
H. IELZIT									57	57								16					16
ISTOG							85	53		138								14	10			24	
JUNIK										0								14				14	
KAÇANIK									67	67								8				8	
KAMENICË							107	217		324								26	9			35	
KLINË							144	43		187													0
KLOKOT										0													0
LEPOSAVIQ										0													0
LIPJAN										0								31	7	7		45	
MAKSHEVË										0								138	3			141	
MAMUSHË							46			46								38				38	
MITROVICË		2	409	4			297	141	25	878								10				10	
MITROVICË V.										0												0	
N. BËRDË							38			38								1				1	
OBILIQ										0								127	25	4		156	
PARTESH										0												0	
PEJË	2					1	194	710	185	1092	193							43				236	
PODUJEVË							294	11	19	324								136	11	3		150	
PRISHTINË		129	734				54	694	149	1760		105	15	5	3	1	4	18	778	5		934	
PRIZREN	62				5	21	422	386	63	959	70						16	63	92			241	
RAHOVEC										0							8	27	27	2		64	
RANILLUG										0												0	
SHTËRPCE										0												0	
SHTIME							15	235		250								55				55	
SKËNDERAJ							52	33		85								41	5			46	
SUHAREKË					16		387	257		660							2	76	1			79	
VITI							86	118		204								38	59			97	
VUSHTRRI										0	37							12	53			102	
Z.POTOK										0												0	
ZVEÇAN										0												0	
Gjithsej	77	131	1143	4	5	414	2570	3313	449	8106	366	105	15	5	3		79	0	1337	1313	101	3324	

6. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, PRILL 2026

Situata epidemiologjike me patogjen respirator

Sipas të dhënave të publikuara për muajin prill të vitit 2026, aktiviteti i infeksioneve respiratore në Rajonin Evropian vazhdon të mbetet në nivele të ulëta dhe në përputhje me pritjet sezonale për këtë periudhë të vitit. Qarkullimi i virusit të gripit ka rënë nën pragun epidemik, ndërsa raportimet laboratorike tregojnë një ulje të vazhdueshme të rasteve pozitive. Dominues mbeten viruset e tipit A, përkatësisht nën-tipet A(H3) dhe A(H1)pdm09, të cilat vazhdojnë të qarkullojnë në nivele të kufizuara. Aktiviteti i SARS-CoV-2 (COVID-19) paraqitet stabil dhe në nivele bazë, pa evidencë për rritje të transmetimit në komunitet apo për shtim të barrës klinike në institucionet shëndetësore. Në të njëjtën kohë, edhe virusi respirator sincicial (RSV) është në trend të rënies, si në numrin e rasteve të detektuara ashtu edhe në përqindjen e mostrave laboratorike pozitive. Nga aspekti i ashpërsisë së sëmundjes, të dhënat mbi rastet e rënda të infeksioneve respiratore akute (SARI) nuk tregojnë rritje të konsiderueshme për gripin, COVID-19 apo RSV. Vlerësimet e mortalitetit në nivel evropian mbeten brenda kufijve të pritshëm sezonal dhe nuk evidentohet tejkalim i pragjeve të zakonshme të vdekshmërisë. Në përgjithësi, situata epidemiologjike në Rajonin Evropian karakterizohet nga aktiviteti i ulët i viruseve respiratore dhe mungesë e presionit të shtuar mbi sistemet shëndetësore.

Ethet Dengue

Gjatë periudhës raportuese vazhdon shpërthimi i dengës në territorin e New Caledonia, me mbi 600 raste të raportuara që nga fillimi i vitit 2026. Përhapja e virusit lidhet kryesisht me praninë e vektorit *Aedes aegypti*, ndërsa kushtet klimatike, përfshirë temperaturat e larta dhe reshjet, po kontribuojnë në rritjen e densitetit të mushkonjave dhe në përhapjen e infeksionit. Lëvizjet e popullatës, sidomos gjatë periudhave të pushimeve dhe aktiviteteve sezonale, konsiderohen faktorë shtesë që mund të ndikojnë në shpërndarjen e virusit në zona të ndryshme të territorit. Autoritetet lokale shëndetësore po zbatojnë masa të kontrollit vektorial, përfshirë përdorimin e metodave biologjike si mushkonjat e infektuara me *Wolbachia*, me qëllim të reduktimit të transmetimit të virusit. Sipas vlerësimit të ECDC-së, rreziku për udhëtarët drejt këtij territori vlerësohet mesatar, ndërsa rreziku për përhapje sekondare në Evropë mbetet shumë i ulët për shkak të kushteve jo të favorshme për aktivitetin e vektorit gjatë kësaj periudhe të vitit.

Influenca Aviane A(H9N2)

Më 21 mars 2026, Organizata Botërore e Shëndetësisë u njoftua për një rast human të konfirmuar me influencë aviane A(H9N2) tek një mashkull adult në Itali, me histori qëndrimi mbi gjashtë muaj në Senegal. Pacienti u paraqit me ethe dhe kollë persistente menjëherë pas kthimit, ndërsa hetimi laboratorik identifikoi bashkë-infeksion me *Mycobacterium tuberculosis* dhe virus të influencës A të pa-nëntipizuar fillimisht. Konfirmimi përfundimtar i nëntipit A(H9N2) u realizua përmes sekuencimit gjenomik, me karakteristika gjenetike të ngjashme me shtamet që qarkullojnë në shpendët në Senegal, duke sugjeruar burim zoonotik të infeksionit. Pacienti u menaxhua në kushte izolimi me presion negativ dhe trajtim specifik (antituberkular dhe antiviral me oseltamivir), me ecuri klinike të përmirësuar. Megjithëse nuk u identifikua ekspozim i drejtpërdrejtë ndaj shpendëve apo kontakt me raste humane, hetimet epidemiologjike mbi burimin e infeksionit janë në vazhdim. Gjurmimi i kontakteve nuk ka evidencuar transmetim sekondar: kontaktet në Senegal ishin asimptomatike, ndërsa ato në Itali rezultuan negative për influencë dhe përfunduan periudhën e monitorimit aktiv dhe karantinës sipas protokolleve, duke marrë gjithashtu profilaksi antivirale. Në tërësi, rasti paraqet një infeksion sporadik zoonotik pa evidencë për transmetim ndërhuman.

Influenca Aviane A (H7N7)

Më 3 prill 2026, Taiwan Centers for Disease Control (Qendra për kontrollin e sëmundjeve në Taivan) raportoi rastin e parë human të konfirmuar me influencë aviane A(H7N7) në Taivan, tek një pacient në dekadën e shtatë të jetës me komorbiditete. Fillimi i simptomave u regjistrua më 20 mars 2026, me tablo klinike të përbërë nga rinorre, mialgji dhe kollë, ndërsa përkeqësimi klinik me ethe çoi në hospitalizim më 22 mars dhe diagnozë të pneumonisë. Ekspozimi epidemiologjik lidhet me kontakt paraprak me shpendë shtëpiakë. Konfirmimi laboratorik u realizua përmes sekuencimit gjenomik të mostrave respiratore (sputum), duke identifikuar virusin A(H7N7) pa mutacione të njohura për rritje të transmetueshmërisë ndërnjerëzore dhe pa rezistencë ndaj antiviraleve, duke sugjeruar ndjeshmëri ndaj trajtimit specifik.

Analiza gjenetike e klasifikon virusin në linjën euroaziatike, në përputhje me shtamet që qarkullojnë në shpendët e egër lokalë. Hetimi epidemiologjik ka identifikuar 33 kontakte, të cilat janë vendosur nën mbikëqyrje shëndetësore; disa prej tyre kanë marrë profilaksi antivirale, ndërsa testimet tek kontaktet familjare kanë rezultuar negative, duke mos evidentuar transmetim sekondar. Mostrat mjedisore nga ferma e implikuar kanë rezultuar negative, ndërkohë që mbikëqyrja është zgjeruar në fermat përreth dhe në popullatat e shpendëve të egër. Autoritetet kanë intensifikuar mbikëqyrjen e integruar humane dhe veterinare, si dhe masat parandaluese në zinxhirin e prodhimit blegtoral. Ky përfaqëson rastin e parë të raportuar të A(H7N7) në Taivan. Historikisht, raste humane janë dokumentuar rrallë, si gjatë shpërthimit në Holandë në vitin 2003 dhe në Itali në vitin 2013, kryesisht tek individë me ekspozim profesional ndaj shpendëve. Në këto episode, shumica e rasteve kanë qenë me ecuri të lehtë klinike, megjithëse janë raportuar edhe forma të rënda, përfshirë raste fatale të komplikuar me sindromë të distresit respirator akut.

Situata epidemiologjike mbi shpërthimin e Salmonellës në Kanada

Gjatë periudhës raportuese vazhdon shpërthimi i infeksioneve nga Salmonella spp. në Kanada, i lidhur me konsumimin e fëstëkëve dhe produkteve të tyre. Numri kumulativ i rasteve ka arritur në rreth 189, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e pacientëve kanë kërkuar trajtim spitalor. Autoritetet shëndetësore kanë ndërmarrë masa të gjera kontrolli, përfshirë tërheqjen e produkteve të kontaminuara nga tregu dhe kufizimin e importit nga vendet e implikuara. Shpërndarja e rasteve në disa provinca sugjeron për ekspozim të vazhdueshëm ndaj një burimi të përbashkët të kontaminimit. Ky shpërthim paraqet rëndësi të veçantë për sigurinë ushqimore dhe nënvizon nevojën për vigjilencë të shtuar në zinxhirin e furnizimit ushqimor, si dhe për forcimin e monitorimit ndërkombëtar të produkteve ushqimore me qëllim të parandalimit të rasteve të ngjashme në të ardhmen.

7. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>

E-mail: QOE.IKSHP@rks-gov.net

Telefoni+38338 541432



